



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN KRYESISHT TË SEKRETARËVE TË KZAZ NR. 42 DHE TË KZAZ NR. 44, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 28.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Lirimin dhe emërimin kryesisht të sekretarëve të KZAZ nr. 44 dhe të KZAZ nr. 42, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 29, pika 5, neni 30, neni 31, neni 32 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoji diskutimet e të pranishmëve,

V Ë R E N

Me shkresën nr. 3603 prot., datë 25.05.2019, sekretarja e emëruar kryesisht nga KQZ për plotësim të vakancës në KZAZ nr. 44, zj. Nurie Lluca, ka deklaruar dorëheqjen nga detyra për arsye objektive.

Me shkresën nr. 4923 prot., datë 28.05.2019, sekretarja e emëruar kryesisht nga KQZ për plotësim të vakancës në KZAZ nr. 42, zj. Jorida Vrapit, ka deklaruar dorëheqjen nga detyra për arsye objektive.

Në listën e shtetasve miratuar nga KQZ me vendimin nr. 140, datë 9.04.2019, pas plotësimit të vakancave të KZAZ me emërimet kryesisht nga KQZ:



Nr. 670 i Vendimit Data 28.05.2019 e Vendimit Ora 12:00 e Vendimit

Për lirimin dhe emërimin kryesisht të sekretarëve të KZAZ nr. 42 dhe të KZAZ nr. 44, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

- rezultojnë të pa emëruar 231 shtetas,
- nuk rezultojnë shtetas të paemëruar me arsim juridik dhe vendbanim në Bashkinë Peqin dhe në Bashkinë Kavajë

Në shqyrtim të kërkesave të shtetasve në përgjigje të njoftimit publik të KQZ-së, por që për shkak të paraqitjes në tejkalim të afatit të përcaktuar, nuk janë bërë pjesë e lidhjes 1 të vendimit nr. 140, datë 09.04.2019, rezultojnë se:

- Z. Klejdi Sufali, shtetas me vendbanim në Bashkinë Peqin,
- Zj. Jonida Qerosi, shtetase me vendbanim në Bashkinë Kavajë,

kanë paraqitur kërkesë për t'u emëruar kryesisht sekretarë të KZAZ-ve, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenet 30 dhe 31 të Kodit Zgjedhor, i propozohen KQZ-së për t'u emëruar kryesisht sekretarë të KZAZ nr. 44 dhe KZAZ nr. 42.

Kërkesat e paraqitura janë në përputhje me nenet 30, 31 dhe 32 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 29, pika 5, nenin 30, nenin 31, nenin 32, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

1. Të lirojë nga detyra sekretaren e KZAZ-së nr.44, zj. Nurie Lluca, Bashkia Peqin dhe sekretaren e KZAZ-së nr. 42, zj. Jorida Vrapit, Bashkia Kavajë.
2. Të emërojë kryesisht sekretarin e KZAZ-së nr.44, z. Klejdi Sufali, Bashkia Peqin dhe sekretaren e KZAZ nr.42, zj. Jonida Qerosi, Bashkia Kavajë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare



Nr. 670 i Vendimit Data 28.05.2019 e Vendimit Ora 12:00 e Vendimit

Për lirimin dhe emërimin kryesisht të sekretarëve të KZAZ nr. 42 dhe të KZAZ nr. 44, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.